



KOMUNA E PRISHTINËS

Kryetari i Komunës

01. nr. 561 - 290744, më 29.11.2016

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L-40, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/2008), në bazë Rregullore nr. 04/2016 për riintegrimin e personave të riatdhesuar dhe menaxhimin e programit të riintegrimit të nenit 30 paragrafi 1 dhe nenit 32, paragrafi 4 të kësaj Rregulloreje, të nenit 52 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe Vendimit të Komisionit Komunal për Riintegrim në Komunën e Prishtinës, të dt. 06.12.2016, Kryetari i Komunës së Prishtinës më 07.12.2016, merr këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e **Ajet Mirjani** me bashkëshorten, të kthyer nga Franca më 18.07.2016 për mbështetje nga programi i Riintegrimit për *Riintegrim* sipas kërkesës nr. 561-290744, të datës 29.11.2016 të parashtruar Komisionit Komunal për Riintegrim në Komunën e Prishtinës.
- II. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Komunal për Riintegrim, në seancën e mbajtur më 06.12.2016 ka shqyrtuar kërkesën e parashtruar nga i riatdhesuari **Ajet Mirjani** nr. 561-290744, të datës 29.11.2016 në Komunën e Prishtinës për përfitim nga Programi i Riintegrimit për *riintegrim*.

Komisioni ka shqyrtuar të gjitha dokumentet e prezantuara dhe sipas dëshmimeve të paraqitura, konstaton se i riatdhesuari **nuk i plotëson** kriteret për mbështetje nga Programi i Riintegrimit të përcaktuara me nenin 3, paragrafi 1, pika 1.1 të Rregullores QRK nr. 04/2016 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e Programit të Riintegrimit, ku përcaktohet se kush konsiderohet person i riatdhesuar, e që i përmenduri nuk plotëson asnjë kriter të riintegrimit pasi që posedon dokumentacion të rregullt dhe vizë valide, nuk është dëbuar nga shteti, nuk ka hyrë ilegalisht në atë shtet, nuk ka rënë në konflikt me ligjet e atij shteti dhe i'u ka njohur e drejta e vendqëndrimit, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh pas pranimit të tij, mund të paraqes ankesë në Komisionin e Ankesave.

U DËRGOHET

Qendrës për Shërbim me Qytetarë

ZKKK-së

Koordinatorit Rajonal të MBP-së

Ajet Mirjani

